

V E N D I M
Nr. 82, datë 4.2.1998

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 356, DATË
10.9.1997 “PËR EMËRIMIN E GUVERNATORËVE DHE ZËVENDËSGUVERNATORËVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE
FINANCIARE E TË ZHVILLIMIT”**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 356, datë 10.9.1997 “Për emërimin e guvernatorëve dhe zëvendësguvernatorëve të Republikës së Shqipërisë pranë institucioneve ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit”, pas pikës 12 shtohen dy pika me këtë përmbajtje:

“13. Zëvendësministri i Financave të emërohet guvernator i Republikës së Shqipërisë pranë Bankës së Tregtisë dhe Zhvillimit të Detit të Zi.

“14. Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes në Ministrinë e Financave të emërohet Zëvendësguvernator i Republikës së Shqipërisë pranë Bankës së Tregtisë dhe Zhvillimit të Detit të Zi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano